



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenit 65 të Ligjit Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.77 / 16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.05/L-150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.10/03 Prill 2017), si dhe nenit 136, dhe nenit 19 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/14 maj 2026), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2026, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR KONTABILITETIN DHE AUDITIMIN E JASHTËM TË INSTITUCIONEVE TË PAGESAVE DHE INSTITUCIONEVE TË PARASË ELEKTRONIKE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton kornizën rregullative për kontabilitetin dhe auditorët e jashtëm të institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike (në tekstin e mëtejme: IP dhe IPE) me qëllim të përcaktimit të cilësisë së shërbimeve të ofruara nga auditorët e jashtëm në raport me rreziqet specifike të IP-ve, IPE-ve dhe të sektorit financiar në përgjithësi. Kjo Rregullore përcakton kërkesat për miratimin e auditorëve të jashtëm, kryerjen e auditimit të jashtëm të IP-ve dhe IPE-ve dhe marrëdhëniet ndërmjet auditorëve të jashtëm, IP-ve, IPE-ve dhe BQK-së.
2. Kjo Rregullore zbatohet për të gjitha institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike të regjistruara nga BQK për të operuar në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha shprehjet përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me shprehjet e përkufizuara në nenin 4 të Ligjit Nr. 10/L-026 për shërbimet e pagesave, dhe/ose siç përcaktohet me poshtë në këtë rregullore
 - 1.1. **Firmë auditimi** – nënkupton një person juridik ose çfarëdo entiteti tjetër, pa marrë parasysh formën ligjore, që është e licencuar në përputhshmëri me Ligjin nr. 04/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim për të kryer auditim ligjor.
 - 1.2. **Pasqyra financiare** – nënkupton pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet plotësuese dhe materialin sqarues të pasqyrave financiare;
 - 1.3. **SNRF** – nënkupton Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të cilat janë standarde ndërkombëtare të kontabilitetit të bazuara në parime, interpretime dhe kornizë të miratuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit;

- 1.4. **Auditor i Jashtëm** – nënkupton vetëm firmat e auditimit;
- 1.5. **Ligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim** – nënkupton Ligjin Nr. 06/l-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, i ndryshuar/plotësuar me Ligjin nr. 10/L-025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim dhe/ose Ligjin në fuqi për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim;
- 1.6. **IP** – nënkupton institucionin e pagesave siç është përcaktuar në Ligjin për Shërbimet e Pagesave;
- 1.7. **IPE** – nënkupton institucionin e parasë elektronike siç është përcaktuar në Ligjin për Shërbimet e Pagesave;
- 1.8. **Institucioni** – nënkupton IP dhe IPE.

Neni 3 **Kushtet e Përgjithshme**

1. IP-të dhe IPE-të mbajnë llogari dhe përgatisin raporte financiare, për të pasqyruar me saktësi pozitën e tyre financiare mbi baza individuale dhe të konsoliduara, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).
2. Llogaritë vjetore dhe llogaritë e konsoliduara të IP-ve dhe IPE-ve auditohen nga auditori i jashtëm. Auditori i jashtëm i një IP dhe IPE të regjistruar në BQK për të operuar në Kosovë licencohet nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (KKRF) dhe miratohet nga BQK.
3. Bazuar në aplikacionin e shkruar, BQK-ja do të miratojë auditor të jashtëm të një IP dhe IPE vetëm nëse plotësohen kushtet në vijim:
 - 3.1. Auditor i jashtëm, i licencuar në Kosovë në pajtim me Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim;
 - 3.2. Auditor i jashtëm, i cili ka së paku 3 (tre) vjet eksperiencë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare të IP-ve, IPE-ve ose të institucioneve tjera financiare, ose stafi pjesëmarrës i të cilit kryen auditimin ka një ekspertizë të tillë.

Neni 4 **Kushtet dhe kërkesat specifike**

1. Miratimi që i jepet auditorit të jashtëm është i kufizuar për një IP ose IPE specifike dhe është i vlefshëm për një vit financiar.
2. Aplikacionet për miratim duhet të dorëzohen në BQK para datës 30 qershor të secilit vit.
3. IP-të dhe IPE-të, së bashku me aplikacionin për miratim, duhet t'i sigurojnë BQK-së:
 - 3.1. Propozimin e Komitetit të Auditimit dhe të Bordit të Drejtorëve, nëse është e aplikueshme, dhe të personave përgjegjës për menaxhim (në mungesë të Bordit të Drejtorëve) për emërimin e auditorit të jashtëm;
 - 3.2. Programin e auditimit për auditimin e IP-së ose IPE-së;
 - 3.3. Përshkrimin e shfrytëzimit të burimeve gjatë shërbimit të auditimit;

- 3.4. Letrën e angazhimit të auditorit të jashtëm ose kontratën e shërbimit të ofruar;
 - 3.5. Dokumentin që vërteton përvojën e mjaftueshme të auditorit të jashtëm apo stafit të tij i cili kryen auditimin në fushën e auditimit të IP-ve, IPE-ve ose institucioneve të tjera financiare;
 - 3.6. Vërtetimin e lëshuar nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF) në lidhje me rezultatet e kontrollit më të fundit të cilësisë për auditorin e jashtëm (ky vërtetim nuk do të kërkohej nga BQK derisa KKRF të mos fillojë të lëshojë një certifikatë të tillë); dhe
 - 3.7. Deklaratën me shkrim të auditorit të jashtëm mbi përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje.
4. Programi i auditimit dhe shfrytëzimi i burimeve gjatë shërbimit të auditimit duhet të jetë i përshtatshëm në raport me karakterin dhe madhësinë e IP-së dhe IPE-së.
 5. Angazhimi i vazhdueshëm i auditorit të jashtëm të njëjtë është i kufizuar në pesë (5) vite ose pesë (5) auditime të njëpasnjëshme, dhe mund të marrë pjesë sërish në auditimin e të njëjtit IP ose IPE pas kalimit të së paku dy (2) viteve.

Neni 5

Reputacion i mirë

BQK do të miratojë si auditor të jashtëm të një IP ose IPE auditorët e jashtëm që kanë reputacion të mirë, të cilët nuk janë të angazhuar në asnjë aktivitet, i cili është në mospërputhshmëri me funksionet e auditimit të jashtëm.

Neni 6

Ribërja e auditimit

BQK ka të drejtën të kërkojë ribërjen e auditimit nga një tjetër auditor i jashtëm, me shpenzimet e IP-së ose të IPE-së, në rastet kur në auditimin fillestar janë identifikuar çështje ose mangësi domethënëse ose kur auditori i jashtëm ekzistues i IP-së ose i IPE-së ka kryer një auditim ose ka paraqitur një raport, i cili nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave, rregulloret në fuqi të BQK-së, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (në tekstin e mëtejshëm: SNA) të aplikueshme përmes Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, dhe nuk shpreh gjendjen financiare të vërtetë dhe të saktë të IP-së ose të IPE-së.

Neni 7

Etika Profesionale

Auditorët e jashtëm do t'i nënshtrohen parimeve të etikës profesionale të përcaktuara nga “Kodi i Etikës për Kontabilistët Profesionistë” të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve.

Neni 8

Pavarësia dhe Objektiviteti

1. Gjatë kryerjes së një auditimi, auditorët e jashtëm duhet të jenë të pavarur nga entiteti që auditohet dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshihen në vendimet e menaxhmentit të IP-së ose të IPE-së

që auditohet. Auditorët e jashtëm nuk duhet të kryejnë auditimin nëse ekziston ndonjë marrëdhënie direkte apo indirekte financiare, pune, punësimi apo çfarëdo marrëdhënie tjetër, përfshirë edhe provizionin për shërbimet jo-audituese shtesë, ndërmjet auditorëve të jashtëm dhe IP-ve ose IPE-ve që auditohen nga e cila marrëdhënie një palë e tretë objektive, e arsyeshme dhe e informuar do të mund të konkludonte se pavarësia e auditorëve të jashtëm është kompromentuar.

2. Auditorët e jashtëm të miratuar, gjithashtu, duhet të jenë në pajtim me dispozitat e Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë të këtij Ligji për çështjen e pavarësisë së auditorit.
3. Auditorët e jashtëm duhet të dokumentojnë në letrat e punës së auditimit të gjitha ndërhyrjet në pavarësinë e tyre, si dhe masat mbrojtëse të aplikuara për zbutjen e ndërhyrjeve të tilla.

Neni 9

Pavarësia dhe objektiviteti i auditorëve të cilët kryejnë auditimin në emër të firmave të auditimit

Pronarët ose aksionarët e një firme auditimi të miratuar, si dhe anëtarët e organeve administrative, menaxhuese dhe mbikëqyrëse të asaj firme, ose të një firme të lidhur, nuk duhet të ndërhyjnë në ekzekutimin e ndonjë auditimi në çfarëdo mënyre e cila do të rrezikonte pavarësinë dhe objektivitetin e auditorit(ëve) i cili kryen auditimin në emër të firmës së auditimit.

Neni 10

Tarifat e auditimit

1. Tarifat e shërbimeve të auditimit:
 - 1.1. Kërkohet të jenë adekuate që të mundësojnë cilësinë e duhur të auditimit;
 - 1.2. Nuk duhet të ndikohen apo përcaktohen nga ofrimi i shërbimeve shtesë për IP-në e audituar; dhe
 - 1.3. Nuk mund të bazohen në asnjë formë të kushtëzimit.

Neni 11

Kërkesat për auditorët e jashtëm gjatë auditimit të llogarive vjetore

Auditorët e jashtëm duhet të kryejnë të gjitha auditimet e IP-ve dhe IPE-ve në pajtim me SNA-të.

Neni 12

Përmbajtja e auditimeve

1. Auditorët e jashtëm duhet të vlerësojnë nëse llogaritë vjetore të IP-ve ose IPE-ve janë përgatitur dhe finalizuar në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Raportim Financiar (SNRF) të zbatueshme nëpërmjet Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe auditim, Ligjin Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave, dhe Rregulloret e BQK-së, si dhe të vlerësojnë nëse menaxhmenti i IP-ve ose IPE-ve e ka plotësuar apo jo obligimin e tij për të siguruar shënime të qarta dhe të duhura si dhe dokumentimin e informatave kontabël në pajtim me Ligjin për Shërbimet e Pagesave dhe Rregulloret e BQK-së.

2. Auditorët e jashtëm duhet të vlerësojnë nëse informatat në raportet vjetore lidhur me llogaritë vjetore, supozimet në lidhje me vazhdimësinë e operacioneve dhe propozimet në lidhje me shfrytëzimin e tepricave apo mbulimin e humbjeve janë në pajtim me Ligjin Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave dhe rregulloret e zbatueshme të BQK-së, si dhe nëse informata është në pajtim me llogaritë vjetore.
3. Auditorët e jashtëm duhet të vlerësojnë mjaftueshmërinë e sistemeve të menaxhimit të rreziqeve të IP-ve ose IPE-ve, bazuar në vlerësimin e:
 - 3.1. Përputhshmërisë me kërkesat për strukturat organizative në lidhje me menaxhimin e çdo rreziku specifik;
 - 3.2. Politikave dhe procedurave për menaxhimin e çdo rreziku specifik dhe zbatimit të tyre;
 - 3.3. Mjaftueshmërisë së identifikimit, matjes dhe monitorimit të çdo rreziku specifik;
 - 3.4. Mjaftueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit të auditimit të brendshëm në lidhje me menaxhimin e çdo rreziku specifik.
4. Rreziqet specifike përfshijnë rrezikun kreditor, rrezikun e tregut, rrezikun operacional, rrezikun e likuiditetit dhe rreziqe të tjera ndaj të cilave ekspozohen IP-të ose IPE-të.
5. Auditorët e jashtëm duhet të sigurojnë që IP dhe IPE kanë planifikuar menaxhim të kënaqshëm të aseteve dhe se ekzistojnë kontrolle të brendshme të duhura.
6. Auditorët e jashtëm duhet të sigurojnë që IP dhe IPE kanë një kornizë të kënaqshme që përfshin mjete, procedura dhe praktika të ndryshme për ruajtjen e fondeve.
7. Auditimi i IP-së dhe IPE-së duhet të mbulojë fusha të tilla si mjaftueshmëria e kontrolleve të brendshme mbi raportimin financiar.
8. Auditorët e jashtëm duhet që nëpërmjet auditimeve të kontribuojnë në parandalimin dhe shpalosjen e parregullsive dhe gabimeve.

Neni 13

Detyrat e auditorëve të jashtëm

1. Auditorët e jashtëm duhet të kryejnë auditime sipas gjykimit të tyre më të mirë, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut që paraqet përfshirja e informatave të gabuara në llogaritë vjetore për shkak të parregullsive ose gabimeve.
2. Auditorët e jashtëm duhet të sigurojnë se kanë një bazë të mjaftueshme për të vlerësuar nëse është bërë ndonjë shkelje e Ligjit Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave si dhe rregulloret e aplikueshme të BQK-së dhe nëse ato janë materiale për llogaritë vjetore.
3. Auditorët e jashtëm duhet të kontrollojnë mjaftueshmërinë, saktësinë dhe plotësinë e raportimeve të IP-së ose IPE-së të paraqitura në BQK në përputhje me kërkesat rregullatore në fuqi të miratuara nga BQK. Bazuar në auditimin e kryer, auditorët e jashtëm duhet të vlerësojnë nëse raportimet janë kryer në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave dhe Rregulloret e BQK-së dhe nëse ato pasqyrojnë në mënyrë realiste dhe objektive pozitën financiare të IP-së ose IPE-së.

4. Auditorët e jashtëm duhet t'i paraqesin me shkrim Bordit të Drejtorëve, nëse është e aplikueshme, dhe personave përgjegjës për menaxhim (në mungesë të Bordit të Drejtorëve) të IP-së dhe IPE-së rrethanat e mëposhtme:
 - 4.1. Mangësitë në lidhje me detyrimin për të siguruar regjistrimin dhe dokumentimin e duhur dhe të qartë të informacionit kontabël;
 - 4.2. Gabimet dhe mangësitë në organizimin dhe kontrollin e menaxhimit të aseteve;
 - 4.3. Parregullsitë dhe gabimet që mund të shkaktojnë informim të gabuar në llogaritë vjetore.

Neni 14 **Dokumentimi i detyrës**

Ashtu siç kërkohet nga SNA 230, “Dokumentimi i Auditimit”, auditorët e jashtëm duhet të dokumentojnë se si është kryer një auditim, si dhe rezultatet e auditimit në mënyrë të mjaftueshme. Çështjet që tregojnë se mund të ketë parregullsi ose gabime duhet të dokumentohen veçmas.

Neni 15 **Mirëmbajtja e dokumenteve të punës së auditimit**

Dokumentet e punës së auditimit duhet të përgatiten dhe mirëmbahen në pajtim me SNA-në përkatëse.

Neni 16 **Raporti i auditorëve të jashtëm**

1. Auditorët e jashtëm duhet të përgatisin një raport vjetor të auditimit me një opinion të auditimit në pajtim me SNRF dhe, në rast të paraqitjes së diferencave materiale, ata gjithashtu duhet të përgatisin një raport auditimi me një opinion të auditimit në pajtim me Rregulloret në fuqi të BQK-së.
2. Raporti i auditimit duhet të konfirmojë se shërbimet e auditimit janë kryer në pajtim me dispozitat e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, këtë Rregullore dhe rregulloret tjera përkatëse të BQK-së.
3. Raporti i auditimit duhet të verifikojë dhe shpalosë çështjet në vijim:
 - 3.1. Nëse llogaritë vjetore janë përgatitur dhe finalizuar në pajtim me SNRF, Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim dhe rregulloret përkatëse të BQK-së, si dhe nëse ato paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të gjendjes financiare dhe aktiviteteve të IP-së dhe IPE-së;
 - 3.2. Nëse menaxhmenti i IP-së dhe IPE-së e ka përmbushur detyrën e tij për të siguruar shënime dhe dokumentimin e duhur dhe të qartë të informatave kontabël; dhe
 - 3.3. Nëse informatat në raportin vjetor në lidhje me llogaritë vjetore, supozimet në lidhje me vazhdimësinë e operacioneve dhe propozimet në lidhje me shfrytëzimin e tepricave apo mbulimin e humbjeve, janë në pajtim me Ligjin Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave dhe Rregulloret përkatëse të BQK-së, si dhe nëse informatat janë në përputhje me llogaritë vjetore.

4. Nëse llogaritë nuk japin informata lidhur me rezultatin dhe gjendjen e IP-së dhe IPE-së, e që duhet të sigurohen, auditorët e jashtëm duhet ta theksojnë këtë, ose të përcaktojnë rezervat e auditorëve dhe mundësisht të sigurojnë informata të nevojshme plotësuese në raportin e auditimit.
5. Nëse auditorët e jashtëm arrijnë në përfundim se llogaritë nuk duhet të finalizohen në formën e tyre aktuale, kjo duhet të theksohet në mënyrë të qartë në raportin e auditimit.
6. Auditorët e jashtëm duhet të vlerësojnë zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditorët e jashtëm për vitin e kaluar financiar.

Neni 17

Letra e menaxhmentit

1. Auditorët e jashtëm duhet, që në pajtim me legjislacionin primar dhe atë sekondar të BQK-së, të përgatisin letrën e menaxhmentit për institucionin financiar, për konkludimet e procesit të auditimit. Letra e menaxhmentit duhet të përfshijë të gjitha konkludimet në të cilat ka arritur auditori i jashtëm në lidhje me aktivitetin ose gjendjen financiare të institucionit financiar, si dhe informatat në lidhje me kujdesin e tyre të kryer gjatë shërbimit të auditimit.
2. Në letrën përfundimtare të menaxhmentit, auditorët e jashtëm duhet të japin një deklaratë specifike në lidhje me sistemin e kontrolleve të brendshme me qëllim që të ofrojnë siguri specifike mbi strukturën e kontrollit të brendshëm dhe me qëllim të shpalosjes së çështjeve materiale. Deklarata specifike, gjithashtu, duhet të përfshijë komente mbi funksionin e auditimit të brendshëm.

Neni 18

Konfidencialiteti

1. Auditorët e jashtëm dhe stafi tjetër i angazhuar në auditim kanë për detyrë të ruajnë konfidencialitetin sa i përket çfarëdo njohurie të përfutur gjatë kohës së aktiviteteve të tyre, përveç nëse me ligj përcaktohet ndryshe, ose për personin me të cilin ka të bëjë informacioni, nuk zbatohet detyrimi i fshehtësisë profesionale. Auditorët e jashtëm dhe bashkëpunëtorët e auditorëve të jashtëm nuk mund t'i shfrytëzojnë ato informata për aktivitetet e veta, për shërbim ose punësimin e të tjerëve.
2. Pa marrë parasysh kufizimet nga paragrafi 1 i këtij neni apo detyrimin e konfidencialitetit të dakorduar, auditorët e jashtëm mund të japin shpjegime dhe të paraqesin dokumentacion rreth detyrës së auditimit, kur kërkohet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
3. Detyra e konfidencialitetit vazhdon të zbatohet edhe pasi të ketë përfunduar detyra e tillë.

Neni 19

Detyra për të informuar

1. Auditori i jashtëm, brenda kornizave të detyrës së tij, duhet të ofrojë informata në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me IP-të dhe IPE-të, të cilat auditori i jashtëm i ka mësuar gjatë auditimit, kur kjo kërkohet nga mbledhja e përgjithshme e aksionarëve, bordi i drejtorëve, menaxhmenti i lartë, komiteti i auditimit ose nga një person i autorizuar nga BQK.
2. Auditori i jashtëm duhet të informojë menjëherë Komitetin e Auditimit ose Bordin e Drejtorëve të IP-së ose IPE-së dhe BQK-në kur auditori, gjatë kryerjes së auditimit të IP-së dhe IPE-së, vëren:

- 2.1. Konflikt serioz brenda organeve vendimmarrëse ose largimin e papritur të menaxherit që ka pasur funksion kyç;
 - 2.2. Informatën e cila tregon se mund të ketë shkelje materiale të ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve dhe rregulloreve të BQK-së, si dhe të statutit dhe akteve nënligjore të IP-së dhe IPE-së; ose
 - 2.3. synimin e auditorit të brendshëm për të dhënë dorëheqje ose se ekzistojnë synime për të shkarkuar auditorin e jashtëm; ndryshime negative ose materiale që paraqesin rrezik për punën e IP-së dhe IPE-së dhe mundësinë që rreziku të vazhdojë.
3. Auditori i jashtëm, duhet që në bazë të kërkesës së BQK-së, t'i ofrojë BQK-së çfarëdo informate, gjatë tërë shërbimit të auditimit, në lidhje me performancën e tij në shërbimet e auditimit në një IP dhe IPE.
 4. BQK mban kontakte të rregullta dhe mund të iniciojë takime me auditorin e jashtëm të IP-së dhe IPE-së në çdo kohë kur kontaktet e tilla konsiderohen të nevojshme.

Neni 20

Kontrolli i cilësisë dhe rishikimi i tij

1. Auditorët e jashtëm të miratuar nga BQK duhet të zbatojnë politikat dhe procedurat adekuate të kontrollit të cilësisë të cilat i adresojnë të gjitha aspektet e rëndësishme të auditimit.
2. Auditorët e jashtëm të miratuar nga BQK do t'i nënshtrohen rishikimit të sigurimit të cilësisë nga ana e BQK-së.
3. Rishikimi i cilësisë së një auditori të jashtëm të miratuar duhet të përfshijë një detyrë specifike të auditimit dhe duhet të kryhet nga ana e BQK-së ose nga ana e një rishikuesi të caktuar nga BQK.
4. Gjatë rishikimit të cilësisë, BQK ose rishikuesi duhet të përcaktojë se deri në çfarë shkalle, auditori i jashtëm i ka aplikuar politikat dhe procedurat adekuate të kontrollit të cilësisë që adresojnë të gjitha aspektet e rëndësishme të auditimit. Gjatë rishikimit, BQK ose rishikuesi duhet të kenë qasje në dokumentet e punës të auditorit të jashtëm, deri në atë masë që është e nevojshme për të kryer një kontroll të mjaftueshëm dhe adekuat të cilësisë.
5. Sa i përket detyrimeve për konfidencialitet, neni 18 i kësaj Rregullore zbatohet njëjloj si për BQK-në ashtu edhe për rishikuesin e cilësisë (auditorin e jashtëm).
6. Rezultatet e përgjithshme të rishikimit të sigurimit të cilësisë publikohen nga BQK, duke përfshirë rekomandimet, vazhdimësinë e rekomandimeve dhe, nëse lind rasti, sanksionet.

Neni 21

Shkarkimi dhe Dorëheqja

1. Auditorët e jashtëm të IP-së dhe IPE-së mund të shkarkohen vetëm kur ekzistojnë baza të mjaftueshme për këtë. Dallimet e opinioneve rreth trajtimeve kontabël ose procedurave të auditimit nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme për shkarkim.
2. Si IP-të ose IPE-të e audituar ashtu edhe auditorët e jashtëm duhet të informojnë BQK-në për shkarkimin ose dorëheqjen dhe duhet të japin shpjegime adekuate për arsyet e vendimit të tillë.

Neni 22

Tërheqja e miratimit

Miratimi i auditorit të jashtëm do të tërhiqet nëse reputacioni i mirë i asaj firme auditimi është cenuar seriozisht ose nëse njëra nga kërkesat e kësaj rregulloreje nuk përmbushet më.

Neni 23

Zbatimi, masat përmirësuese dhe ndëshkimet administrative

1. Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Rregulloreje i nënshtrohet masave ndëshkuese administrative, siç janë përcaktuar në neni 67 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150, dhe nenin 125, të Ligjit Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave.
2. Nëse auditorët e jashtëm të IP-ve dhe IPE-ve kanë shkelur detyrat e auditorit në përputhje me kornizën përkatëse ligjore në fuqi, dispozitat e kësaj rregulloreje si dhe rregulloreve të tjera përkatëse të BQK-së, BQK mund t'i shqiptojë auditorit të jashtëm një vërejtje me shkrim, një kopje e së cilës i dërgohet IP-së dhe IPE-së së audituar.
3. Nëse shkeljet e përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni përsëriten, BQK ka të drejtë të:
 - 3.1. refuzojë miratimin e auditorit të jashtëm për t'u angazhuar në kryerjen e auditimit të institucioneve financiare të licencuara nga BQK për të vepruar në Republikën e Kosovës; ndalimi për miratimin e auditorit të jashtëm mund të zgjasë deri në tre (3) vite;
 - 3.2. kërkojnë largimin ose zëvendësimin e një auditori të jashtëm;
 - 3.3. drejtpërdrejt të emërojë, largojë ose zëvendësoni një auditor të jashtëm, ose
 - 3.4. kërkojnë ribërjen e auditimit sipas nenit 6 të kësaj rregullore.

Neni 24

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga data e miratimit të saj.

Dr.sc. Bashkim Nurboja
Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës